

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-198/2014

**Prishtinë,
25 Janar 2017**

Në çështjen juridike të:

M. Đ.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës ,i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPPC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA17501 dhe KPA17502), 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 25 Janar 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e parashtruara nga M. Đ. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013, të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-198/2014 dhe GSK-KPA-A-199/2014 bashkohen në një lëndë me numër GSK-KPA-A-198/2014.
2. Ankesat e M. Đ. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013, lidhur me Kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA17501 dhe KPA17502, refuzohen si të pa bazuara.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013, lidhur me Kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA17501 dhe KPA17502.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 16 tetor 2006, M. Đ. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala ankuese) ka parashtruar ndaras dy Kërkesa pranë Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) në cilësinë e anëtarit të familjes të titullarit të së drejtës pronësore: babait të tij të ndjerë P. Đ. Kërkesat ishin regjistruar në AKP me numrat KPA17501 dhe KPA17502 dhe referoheshin në pronat, përkatësisht ngastrat nr. 2243, 2244, 2245 dhe 2246, në sipërfaqe prej 05.92.56 ha gjithsejtë, si dhe ngastrën nr. 2247 në sipërfaqe të tërësishme prej 00.20.65 ha, e që gjendeshin në vendin e quajtur “Restavica Šuma” në Junik, Komuna e Deçanit (në teksine mëtutjeshëm: prona e pretenduar). Sipas Palës ankuese, prona e kërkuar shfrytëzohej nga persona të panjohur.
2. Pala ankuese ka theksuar se humbja e posedimin të pronës kontestuese që ka ndodhur me 12 qershor 1999 ka qenë e lidhur me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të viteve 1998 dhe 1999.
3. Pala ankuese në mbështetje të kërkesës së tij i ka siguruar AKP-së, ndër të tjera me dokumentet e mëposhtme:
 - Kopjen e certifikatës së lindjes së palës ankuese Nr. 03-9/90, të lëshuar me 30 janar 1961 nga Komuna e Gjakovës.
 - Kopjen e letër njofimit të palës ankuese Nr. CG017263, të lëshuar me 30 prill 1982 nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë- Republika Socialiste e Malit të zi;
 - Kopjen e planit të lëshuar me 26 shtator 1995 nga zona kadastrale e Junikut, Komuna e Deçanit;

- Kopjen e Historiatit nr. 952-2/695, të lëshuar me 26 shtator 1995 nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Deçanit, që thekson se prona e pretenduar është bartur në fletën poseduese nr. 574 nën emrin e Ndërmarrjes Shoqërore “Ereniku” në Gjakovë dhe se gjendja e tillë faktike ekziston deri me tani, ngase ngastrat e theksuara mbesin të regjistruara në emrin e Kombinatit Bujqësor “Ereniku”;
 - Fletën poseduese (FP) Nr. 310, të lëshuar me 26 shtator 1995 nga komuna kadastrale e Junikut, Komuna e Deçanit;
 - Kopjen e Raportit të palës ankuese, të datës 27 qershor 2006, që thotë “...në vitin 1952 veproja si shoqërues personal, kur toka është bartur nën Fermën e shtetit “Ereniku” në Gjakovë.
 - Kopjen e certifikatës nr. 462-47731/2006-02, të lëshuar me 18 shtator 2006 nga Drejtoria për Pronë e Republikës së Serbisë;
 - Deklaratën me shkrim të palës ankuese, të datës 23 janar 2008, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Nikshiqit, Republika e Malit të zi, me numër 7263, e cila thotë “Në vitin 1952 unë isha i punësuar si polic, kur toka e babait tim u transferua në Fermën shtetërore “Ereniku” në Gjakovë. Në atë kohë unë jetoja në Serbi. (...) në vitin 1957 unë u zhvendosa në Nikshiq, Mal i zi. Nëna e imë vazhdoi të jetoj në Rastavicë deri në vitin 1966, pas të cilit vit ajo u zhvendos po ashtu në Nikshiq. Deri me sot, ashtu siç më kanë thënë (...) askush nuk jeton në tokën time”;
 - Kopjen e shënimit të Palës ankuese, të datës 4 shkurt 2010, në të cilën ai e qartëson se “Në vitin 1952, unë isha i punësuar si polic, kur toka e babait tim u transferua në fermën shtetërore “Ereniku” nga Gjakova. Në atë kohë unë kam jetuar në Serbi (...)”.
 - Kopjen e deklaratës së Palës ankuese, të pranuar nga AKP me 22 nëntor 2010. Pala ankuese ka përsëritur se prona e pretenduar është transferuar në Fermën shtetërore “Ereniku” në Gjakovë. Po ashtu ai ka shtuar se fqinjët e tij ,Familja S/S, e kanë pyetur për shitjen e tokës, por ai nuk ka pranuar që të ua shes atyre tokën;
 - Kopja e urdhrit deklarative të Komisionit për Kërkesa Banesore dhe Pronësore të Kosovës (KKBPK), me të cilën kërkesa e Palës ankuese (Paraqitësi i kërkesës pranë KKBPK) sa i përket shtëpisë së shkatërruar që ndodhej në ngastrën Nr. 2246 ishte pranuar.
4. Identifikimi fillestar i pronës së kërkuar është bërë me 9 tetor 2010. Gjatë procesit të identifikimit është gjetur se prona e pretenduar ka qenë pyll i pa-uzurpuar (KPA17501) dhe kullosë (KPA17502).

5. Më pas, identifikimet për të dy Kërkesat u bënë serish me 17 qershor 2010 me metodën e publikimi në Gazetën e njoftimeve të KPA-së Nr. 2 (që u shpërnda në komunën e Junikut, Gjykatën Komunale, zyrën rajonale të KPA-së në Pejë), gazeta u shpërnda edhe në DRC, OSBE, UNHCR dhe Avokatin e Popullit.
6. Sipas raporteve të verifikimit të APK-së të datës 9 shtator 2011, fleta poseduese nr. 310 e datës 20 shtator 2007 u verifikua negativisht. Prej raporteve të verifikimit të datës 1 dhe 3 shtator 2007, Plani Kadastral (PK) dhe fleta poseduese ishin verifikuar negativisht. Me 3 gusht 2007 dhe 13 janar 2010, Ekipi verifikuese i AKP-së *ex officio* kishte gjetur Fletat poseduese pjesërisht (të panëshkruara) nr. 37, 923, 736, 665, të lëshuara me 20 prill 2007 nga Departamenti për Gjeodezi dhe Kadastër i Komunës së Deçanit (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë). Nga këto dokumente rezultonte se prona e pretenduar është e regjistruara në emra të pronarëve të ndryshëm: përkatësisht ngastrat me numrat 2243 dhe 2247 nën emrin e M.Sh., ngastra numër 2244 nën emrin e F. Sa., ngastra numër 2245 nën emrin e C.A.dhe ngastra numër 2247 nën emrin e M. Sh..
7. Raporti verifikues i AKP-së i datës 1 qershor 2007, tregon se një zyrtar i Departamentit të Kadastrit në Komunën e Junikut e konfirmon se Fleta Poseduese numër 310, e parashtruara nga Pala ankuese, është lëshuar në vitin 1952. Raporti vë në pah edhe faktin se (prona e pretenduar) ngastrat ishin regjistruar në Junik deri në vitin 1983, kur regjistrimi nga ajri i vitit 1983 që hyri në fuqi në vitin 1990, u transferuan në Baballoq. Tutje, po i njëjti raport shpjegon se ngastrat vjetra (numër 2243, 2244, 2245, 2246 dhe 2247) nga fleta poseduese numër 310, kanë marrë numra të ri, përkatësisht numri (i vjetër) i ngastrës 2243 është bërë numri (i ri) i ngastrës 728, numri (i vjetër) i ngastrës 2244 është bërë ngastra (tri të reja) me numër 732, 736 dhe pjesa e 737, dhe se ngastrat (e vjetra) numër 2245, 2246 dhe 2247 u bënë ngastër (e re) numër 737. Sa i përket kësaj, Njësia e verifikimit e AKP-së ka arrit të siguroj ex-officio numrat e të Dhënave të Njesisë Bazë P-70505002-00728-0, P-70505002-00732-0, P-70505002-00736-0 dhe P-70505002-00737-0, të lëshuar me 13 janar 2010 nga Zyra Komunale Kadastrale e Baballoqit, Komuna e Deçanit.
8. Lëndët janë konsideruar si jo-kontestuese nga AKP-ja nga fakti se asnjë palë e interesuara nuk iu është afruar Agjencisë.
9. Me vendimin e ankimuar Nr. KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tutje si “KKPK” ose “Komisioni”) i ka hedhur poshtë Kërkesat me numrat KPA17501 dhe KPA 17502, me arsyetim se Pala ankuese nuk ka arrit të demonstroj se Kërkesa ka të bëjë me rrethana që drejtpërdrejt ndërlidhen ose dalin prej konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999. Rrjedhimisht, sipas Komisionit, kërkesat bien jashtë mandatit të tij.
10. Me 12 qershor 2014, vendimi i KKPK-së iu është dorëzuar Palës ankuese.

11.Me 30 qershor 2014 Pala ankuese ka parashtruar Ankesat.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese e kundërshton Vendimin e KKKPK-së duke pretenduar se është i bazuar në vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të vërtetoj Ankesat e tij dhe të e njoh të drejtën e tij të pronësisë në pronat e pretenduara ashtu që të regjistrohet si pronar. Më tej ai kërkon që toka të iu kthehet atij. Pala ankuese shpjegon se pronari i pronës së pretenduar ishte babai i tij P. D., i cili ka vdekur në vitin 1937, duke e lënë atë me nënën Jovanën në pronë. Pala ankuese shton se ai dhe nëna e tij kanë jetuar dhe si pronarë e kanë shfrytëzuar pronën e pretenduar deri në vitin 1952, kur prona ishte transferuara në “Ndërmarrjen shoqërore Ereniku- Gjakovë” që të krijohej një Kombinat Bujqësor. Ai thekson se në kohën e transferimit të pronës së pretenduar nuk kishte ndonjë dyshim se pronarët do të kompensoheshin dhe se prona e tyre do të iu kthehej. Ai pretendon se askush nuk ka jetuar në pronën e tij dhe se e njëjta nuk ishte e uzurpuar deri në vitin 2012. Në fund ai shton se nuk e di se çka ka ndodhur me pronën pas këtij viti.

Arsyetimi ligjor:

Bashkimi i ankesave

13. Në pajtim me nenin 13.4 të Ligjit Nr. 03/L-079, Gjykata Supreme e Kosovës mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkriura kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i lejon Komisionit që vendos për bashkimin apo shkrirjen e Kërkesave për të shqyrtuar dhe marr vendime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe provuese.

14. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore që zbatohen në procedurat pranë Kolegjit të Apelit të AKP-ës në Gjykatën Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Ligjit Nr. 03/L-079, si dhe në përputhje me dispozitat e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, përcaktojnë mundësin e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes Aktvendimit nëse me këtë do të sigurohej efektiviteti dhe efikasitetin e gjykatës së kësaj lënde.

15. Gjykata Supreme në tekstin e ankesave të parashtruara nga Pala ankuese vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilin është parashtruara Ankesa në fjalë, si faktet, bazat juridike dhe çështjet provuese janë krejtësisht të njëjta në të dy lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale, që janë subjekt i të drejtave pronësore të cilat janë të përmendura në secilin Kërkesë, dallojnë. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë shpjeguese si dhe në dokumente të njëjta. Po ashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për ato vendime është i njëjti.
16. Prandaj, Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-198/14 dhe GSK-KPA-A-199/14 regjistron me një numër të lëndës GSK-KPA-A-218/14.

Meritat

17. Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se vendimi i ankimuar i KKPK-së është marr me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe në themele të tilla si e drejta materiale ashtu edhe e drejta procedurale janë zbatuar mirëfilli. Prandaj, Ankesat refuzohen si të pabazuara.
18. KKPK-ja ka gjetur se Pala ankuese nuk ka arritur që të tregoj se Kërkesat kishin të bëjnë me rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999. Pala ankuese e ka kundërshtuar këtë konstatim juridik të KKPK-së. Por, është më rëndësi të vihet në pah se Pala ankuese në deklaratën e tij (të pranuar nga AKP me 22 nëntor 2015) të parashtruara në AKP ka treguar se ai dhe nëna e tij në vitin 1957 u zhvendosen në Nikshiq të Malit të zi. Për më tej, Pala ankuese e ka theksuar po të njëjtën gjë kur është kontaktuar nga AKP-ja (*sbib faqen 103 të shkresave të lëndës së KPA17501, si dhe faqen 102 të KPA17502*). Në të vërtet AKP-ja e kishte pyetur Palën Ankuese kur e kishte humbur posedimin, pse dhe kush ishte duke e përdorur pronën e pretenduar- ai u përgjigj se “[...prona është konfiskuar nga shteti në vitin 1952 ...]”, dhe se ai “[...me familjen e tij, e pastaj është zhvendosur në Mal të zi...]”. Për më tepër, Pala ankuese ka konfirmuar se: “[...ata nuk kanë nisur procedurën për kthimin e pronës... prej viteve të 50ta ai dhe familja e tij kurrë nuk e kanë vizituar Kosovën serish, dhe se prona është në shfrytëzim të NSH “Ereniku” që nga ajo kohë ...]”.
19. Sipas konstatimit juridik të Gjykatës Supreme, Pala ankuese nuk e ka provuar se vërtet ai ka qenë në posedim të pronave të pretenduara para konfliktit dhe humbja e posedimin ka ndodhur në mes të viteve 1998 dhe 1999 për shkak të konfliktit të armatosur apo ka qenë i ndërlidhur me të. Dokumentet e parashtruara nga Pala ankuese nuk e kanë konfirmuar fare këtë rrethanë. Nuk mjafton që Kërkesa(sat) të miratohen, për të mohuar përmbajtjen e vendimit të KKPK-së. Këto elemente duhet të vërtetohet pa ndonjë mëdyshje. Me asnjë prej atyre dokumenteve nuk

- vërtetohet se Pala ankuese apo nëna e tij e kanë poseduar të drejtën pronësore të pretenduar para konfliktit të armatosur.
20. Për më tepër, fakti se Pala ankuese (dhe nëna e tij) nuk e kanë humbur posedimin ndaj pronës së pretenduar nga rrethana që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999, po ashtu mbështetet në deklaratat (e përsëritura) të tij të theksuara në Ankesë ku ka thënë se: (a) “ *Gjatë vitit 1941, paraqitësi i kërkesës dhe nëna e tij ishin përçënë nga Kosova dhe kishin ardhur në Nikshiq...*” dhe (b) “ *Paraqitësi i kërkesës dhe nëna e tij kanë jetuar dhe si pronarë e kanë shfrytëzuar pronën, që është subjekt i kërkesës, deri në vitin 1952*”. Në asnjë prej parashtrësive të Pala ankuese, qoftë pranë KKPK-së e as pranë Kolegjit të Ankesave, nuk ka pretenduar se humbja e posedimit ka qenë e ndërlidhur me konfliktin e armatosur. Fushëveprimi i shqyrtimit të Kërkesave nga KKPK-ja, ka qenë megjithatë i kufizuar në ato lëndë ku humbja e posedimit të pronës ka ndodhur në mes të periudhës së viteve 1998-1999. Duke pas parasysh, se për lëndën në fjalë, rrethana e humbjes së posedimit të pronës kanë ndodhur në vitin 1952 ishte e pa kontestuar, ka bërë që lënda të bie jashtë kompetencës së AKP-së dhe Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme.
21. Prandaj, vendimi i KKPK-së, që vërteton se humbja e posedimit për shkak të konfliktit nuk është provuar, ka qenë i drejtë dhe është dashtë të rezultojë në hedhjen poshtë të Kërkesës si të papranueshme.
22. Në pah të arsyeve të lartcekura, në pajtim me nenin 13.3, pika C, të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 dhe nenit 195, paragrafi 1(d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ankesat janë të pabazuara. Prandaj vendoset si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Këshillë juridike:

23. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit,

Anna Bednarek , Gjyqtar i EULEX-i

Beshir Islami , Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it